

19.04.2019

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“O.B.S.S. ALBANIA” SH.P.K.

#### **NENI 1** FORMIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “O.B.S.S. ALBANIA” sh.p.k. themelohet në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Z.Francesco Favia**, i biri i Nicola, i datëlindjes 24.10.1963, lindur në Bari, Itali dhe banues në Rr. “Napoli” 234 D-70127 Bari, i identifikuar nëpërmjet Pasaportës me Nr.YA5482146, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

#### **NENI 2** SELIA

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “O.B.S.S. ALBANIA” sh.p.k. është në adresën: **Bulevardi “Zogu I”, Pall. 8, Kati 3, Tiranë, Shqipëri.**

Ortaku mund të vendosin për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër.

#### **NENI 3** KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “O.B.S.S. ALBANIA” sh.p.k. është për një periudhë 1 (një) vjeçare.

#### **NENI 4** OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “O.B.S.S. ALBANIA” sh.p.k. do të jetë:

- A) Shërbime në fushën e Marketingut, Marrëdhënie me Publikun (PR).
- B) Shërbime në fushën e Media Planing , Produksioneve Televizive si edhe Produksioneve Marketingu.
- C) Faqe internet, Reklama online dhe offline, Logo, Spote si edhe organizim eventesh.
- D) Shërbime printimi, publikimi, fushata mediatike sensibilizimi si edhe çdo gjë tjetër e lidhur me fushën e Marrëdhënies me Publikun (PR) dhe Marketingut.
- E) Trajnime dhe Workshop-e.

F) Shoqëria për përmbushjen e qëllimit të saj mund të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me persona të tretë.

Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, Shoqëria mund të ushtroje veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj e të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të ngjashëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Për përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria mund:

A) Të zotërojë direkt ose indirekt pjesëmarrje në shoqëri dhe/ose sipërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose që mund të ndihmojnë në realizimin e objektit të Shoqërisë;

B) Të themelojë degë, zyra përfaqësimi dhe në përgjithësi të kryejë çdo aktivitet tjetër që nuk është i ndaluar nga ligji.

## NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "O.B.S.S. ALBANIA" sh.p.k. është 1.000 (një mijë) Lekë, ku ortakut Francesco Favia zotëron 1 (një) kuotë të barazvlefshme me 100% të kapitalit themeltar ose 1,00 pjesë.

Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuotat e Ortakëve regjistrohen në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

## NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë "O.B.S.S. ALBANIA" sh.p.k. janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administratori i shoqërisë, i cili është **Z.Skerdi Sulovari**.

## NENI 7

Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj shprehen në statut i cili së bashku me aktin e themelimit përbëjnë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

## NENI 8

Veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.



## NENI 9

Të gjitha mosmarrveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore, zgjidhen me mirëkuptim me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat, atëhere zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "O.B.S.S. ALBANIA" sh.p.k. në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë. Në këtë ditë shoqëria "O.B.S.S. ALBANIA" sh.p.k. njihet si person juridik.

**ORTAKU I VETËM  
I SHOQËRISË "O.B.S.S. ALBANIA" SH.P.K.**

**Z.FRANCESCO FAVIA**

